

Integrimet Ekonomike Evropiane

Ligjerata 6.


Prishtinë, 2014

V. UNIONI EVROPIAN- HAP I RI NË NDËRTIMIN E MËTEJMË TË ARKITEKTURËS SË BEE-së

- Marrëveshja mbi Unionin Evropian është nënshkruar në Maastricht (Holandë) më 7.2.1992. Vendet nënshkruese: Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Italia, Belgjika, Holanda, Luksemburgu, Danimarka, Irlanda, Spanja, Portugalia dhe Greqia.
- Kjo marrëveshje ndryshoi dhe plotësoi Marrëveshjen për themelimin e tri Bashkësive Evropiane: për Çelik dhe Thëngjill, Energji Atomike dhe Bashkësisë Ekonomike.
- Revizioni më radikal që është bërë në Marrëveshjen mbi themelimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane
- Përmban elemente të reja në bashkëpunimin mes vendeve anëtare në shumë sfera
- Hapi i parë për të qenë pjesë e Unionit është pranimi i konceptit dhe mekanizmit të tregut unik evropian;
 - tregu unik funksionon si një treg i brendshëm i vendeve anëtare;
- UE - një nga potencialet më të mëdha tregtare në botë
 - pjesëmarrja në tregtinë botërore: 20 %

- Në vitin 2002 “pesëmbëdhjetsha evropiane” - më se 370 milionë banorë
- Sipërfaqja prej 3.25 milionë kilometra katrorë
- UE - një treg me fuqi të madhe blerëse
- Bruto produkti i brendshëm (GDP) në vlerë prej 8.145,5 miliardë dollarë
- 25,9 % të vlerës së përgjithshme të GDP-së botërore

Struktura e tregëtisë botërore më 2002



1. ETAPAT THEMELORE NË ZHVILLIMIN E GJERTANISHËM TË UE-së

- Marrëveshja e Parisit (18 prill, 1951) - formimi i Bashkësisë Evropiane për çelik dhe thëngjill;
- Marrëveshja e Romës (25 mars 1957) – themelimi i BEE-së dhe Bashkësisë Evropiane për Energji Atomike (EURO-ATOM);
- Miratimi i Aktit Unik Evropian (3 dhjetor 1985 dhe hyrja në fuqi më 1 korrik 1987)
 - ndërrimi i parë rrënjësor i Marrëveshjes së Romës
 - parashikimi i krijimit të "tregut të brendshëm" (më së largu deri më 31 dhjetor 1992);
- Ndryshimet në Aktin Unik Evropian
 - bëhet thjeshtësimi dhe harmonizimi i ligjshmërive
 - aplikimi i një qasjeje të re të harmonizimit me qëllim të realizimit të unionit ekonomik dhe atij monetar;
 - miratohet parimi i shumicës kualifikuese për marrjen e vendimeve që janë me rëndësi për krijimin e tregut unik evropian;
 - Parlamenti Evropian fiton autorizime të reja në sferën e aktiviteteve legjislative.

-Parlamentit i bartet autorizimi për marrjen e të gjitha vendimeve të rëndësishme për formimin e Unionit Ekonomik dhe Monetar.

▪ Ndërmirren aksione të ndryshme në procesin e formimit të unionit ekonomik dhe monetar me qëllim të:

- konsolidimit të bazës shkencore dhe teknologjike;
- harmonizimit të ligjshmërive për sigurim dhe shëndetësi;
- ruajtjes së ambientit jetësor.

➤ **Dinamika e krijimit të "tregut të brendshëm" – sjell deri te propozimi për vazhdimin e mëtejme të integritimit;**

▪ Qëllimi: realizimi i plotë i Unionit Ekonomik dhe Monetar

➤ Zhdukja e komunizmit dhe e ndarjes në blloqe të Evropës- nxitje për krijimin e "Unionit politik".

1.1. Etapat e themelimit të Unionit Ekonomik dhe Monetar

Etapa e I-rë

- Vëmendje e posaçme - Fondit për adaptime strukturale ;
- Stimulimi i zhvillimit rajonal dhe eliminimin e dallimeve ekzistuese;
- Kalimi prej sistemit të konvergjencave në sistemin e koordinimit të politikave ekonomike:
 - marrëveshjet reciproke mbi metodat, masat dhe instrumentet e politikës makroekonomike të vendeve të ndryshme ;
 - mbikqyrja multilaterale e politikës ekonomike dhe realizimi i saj;
 - Procesi i gjatë dhe i vështirë i ratifikimit;
 - referendumi i përsëritur në Danimarkë dhe Francë;
 - Hyn në fuqi Marrëveshja mbi Unionin Evropian(1 nëntor 1993);
 - Fundi i etapës së parë të zhvillimit të Unionit Evropian;
 - Arritjet: liberalizimi i plotë i qarkullimit të kapitalit në BEE.

Etapa e II-të (1.1.1994)

➤ Tri drejtimet themelore:

- përcaktimi i qëllimeve buxhetore, monetare dhe fiskale;
- themelimi i mekanizmit evropian të bankave qendrore;
- Bashkësia tejkalon rolin e koordinatorit të thjeshtë në përcaktimin e politikës së përgjithshme monetare;

➤ Forcimi i institucioneve ekzistuese monetare.

➤ Themelimi i Institutit Monetar Evropian (1.1.1994, Frankfurt)
-paraardhëse e Bankës Qendrore Evropiane (Sistemit të Bankave Qendrore të UE-së).

➤ Anëtarët e Institutit: Bankat Qendrore Nacionale (BQN).

➤ Detyrat themelore të Institutit:

- Forcimi i bashkëpunimit në mes të BQN-ve;
 - Forcimi i harmonizimit të politikës monetare të shteteve anëtare;
 - Sigurimi i stabilitetit të çmimeve;
 - Mbikqyrja e funksionimit të Sistemit Monetar Evropian;
 - Marja mbi vete e funksioneve që ishin nën kompetencën e Fondit Evropian për Bashkëpunimin Monetar;
 - Përgatitja e instrumenteve dhe procedurës për zbatimin e politikës unike monetare.
-
- Instituti të pushojë së ekzistuari - pas fillimit të funksionimit të Bankës Qendrore Evropiane;
 - Emetimi i banknotave- Banka Qendrore Evropiane;
 - Kapitali themelues i BQE u vendos të jetë 5 miliardë;
 - Obligimi i vendeve anëtare për t'i siguruar BQE-së rezervat devizore në vlerë prej 50 miliardë;
 - Operacionet devizore të Bankave Qendrore Nacionale - do t'i nënshtroheshin lejes së BQE-së;
 - sigurimi i harmonizimit të tyre me politikën monetare të UE-së;

➤ Shpërndarja e të hyrave monetare të BQE-së

- 20% - fondit rezervë ;
- 80% aksionarëve - Bankave Qendrore Nacionale;
- proporcionalisht me pjesëmarrjen e aksioneve.

Qëllimi i aksioneve në sferën ekonomike në këtë fazë:

- forcimi i politikës së zhvillimit rajonal dhe ndryshimeve strukturale;
- forcimi i bashkëpunimit në planin global makroekonomik.

➤ Në sferën monetare:

- formimi i Sistemit Evropian të Bankave Qendrore ;
- krijimi i një politike monetare të përbashkët.

➤ Në fazën kalimtare – Këshilli i Guvernatorëve autorizohet për koordinimin e politikës monetare

- Hyrja definitive në UM me valutën unike (ECU) dhe me një BQ
- do të varet nga plotësimi i kriteriumeve të konvergjencës.

➤ Analiza e UNCTAD-it më 1994:

- kah fundi i vitit 1992 vetëm dy shtete (Franca dhe Luksemburgu) plotësonin dy kushte (deficiti i buxhetit dhe borxhi publik).

- Italia, Belgjika, Holanda, Portugalia dhe Greqia- nuk plotësonin asnjërin nga këto kushte;
- Gjermania, Britania e Madhe dhe Spanja- kishin deficit të buxhetit;
- Danimarka dhe Irlanda- pjesëmarrja e borxhit publik në produktin shoqëror mbi kriteriumet e parapara;

➤ Tri opsionet për zgjidhjen e këtij problemi:

- Shtyrja e konstituimit të Unionit Monetar;
- Modifikimi i kriteriumeve të konvergjencës;
- Inkuadrimi në Union – edhe pse nuk plotësohen kriteriumet fiskale, por që në vitet e fundit i afrohen këtyre kriteriumeve.

Etapa e III-të

- Nënkupton vendosjen e politikës unike monetare dhe pushtetit qendror monetar.
- **Me valutën unike udhëheqë :**
 - Banka Qendrore Evropiane (European Central Bank) dhe
 - Bankat Qendrore të vendeve anëtare të BEE-së.
- **Detyra kryesore e BQE:**
 - Ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
 - Formulimi i politikës së përbashkët monetare dhe realizimi i saj ruajtja dhe udhëheqja e rezervave devizore të vendeve anëtare.

2. PËRMBAJTJA THEMELORE E MARRËVESHJES SË MASTRIHTIT

➤ Pjesët kryesore të Marrëveshjes së Mاستrihtit janë:

- 1) Dispozitat e përbashkëta të Marrëveshjes;
- 2) Dispozitat që kanë të bëjnë me ndryshimet e Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane me qëllim të formimit të Unionit Evropian;
- 3) Dispozitat që kanë të bëjnë me ndryshimet e Marrëveshjes mbi themelimin e Bashkësisë Evropiane për Thëngjill dhe Çelik;
- 4) Dispozitat që kanë të bëjnë me ndryshimet e Marrëveshjes mbi themelimin e Bashkësisë Evropiane për Energji Atomike;
- 5) Dispozitat që kanë të bëjnë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë;
- 6) Dispozitat mbi bashkëpunimin në sferën e jurisprudence dhe të brendshme;
- 7) Dispozitat përfundimtare.

➤ „Tri shtyllat” e bashkëpunimit të përfshira në Marrëveshjen mbi Unionin Evropian janë:

- Tri Bashkësitë Evropiane;
- Bashkëpunimi në politikën e jashtme të përbashkët dhe të sigurisë;
- Bashkëpunimi në sferën e jurisprudencës dhe punëve të brendshme të vendeve anëtare;

➤ **Politika sociale - lëndë e një protokollit të veçantë**

- Vendet nënshkruese duhet t’i përkrahin dhe plotësojnë aktivitetet e tyre në drejtim të :
 - Përmirësimit të kushteve të punës së punëtorëve;
 - Informimit dhe konsultimeve me punëtorët;
 - çështjeve të tjera me rëndësi nga sfera e interesit të punëtorëve.

➤ Rëndësia e Marrëveshjes së Mاستrihtit:

- Zhvilloi mekanizmin e tregut të brendshëm unik;
- Funksionimi i tregu unik si një treg i brendshëm i vendeve anëtare;
- Tregu i mallrave, shërbimeve, punës dhe kapitalit.